



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Bekim Lestrani, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 13.03.2025 VI-020-125
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 02 Nr. 130/01-8204 për plotësim ndryshim të Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

I miratuar më datë: 28.02.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.03.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 28.02.2025, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 130/01-8204 për plotësim ndryshim të Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 34 të Statutit të Komunës së Glllogocit, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenit 3, 4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, plotësim ndryshimi i vendimit është bërë për arsye se një anëtar i KKSB-së ka dhënë dorëheqje nga pozita e asamblistit të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, si dhe dorëheqja e anëtares tjetër nga pozita e udhëheqëses së KVRL-së.

Akti është miratuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 28.02.2025, është miratuar më 18 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Bekim Lestrani, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erblin Hetemi, rukovodioc Pravnog odeljenja/MALS	Dana, 13.03.2025 VI-020-125
Odgovorni službenici: 1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene: 2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelnice/e,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 02 br. 130/01-8204 o dopuni i izmeni Odluke Opštinskog veća za bezbednost u zajednici
Usvojena dana, 28.02.2025.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 03.03.2025.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Glogovac je na redovnoj sednici održanoj dana, 28.02.2024.godine, odobrila Odluku 02 br. 130/01-8204 o dopuni i izmeni Odluke Opštinskog veća za bezbednost u zajednici.

MALS konstatuje da je akt koji je donet od strane Skupštine opštine Glogovac, zasnovan na članu 11, 12 i 40 Zakona o lokalnoj samoupravi nr.03/L-40, članu 34 Statuta opštine Glogovac (Službeni list Republike Kosovo), članu 17 Zakona br. 04/L-076 o policiji, članovi 3, 4 i 15 Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP - 03/2012 MALS o opštinskim savetima za bezbednost u zajednici, dopuna, izmena odluke je doneta zbog toga što je jedan član OSBZ podneo ostavku na funkciju odbornika Skupštine opštine Glogovac, kao i ostavke još jednog člana na mesto rukovodioca (KVRL).

Odluka je usvojena na redovnoj sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 28.02.2025. godine, sa 18 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržan glas.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

HRYŠE - ULAZNA - INCOMING

Ministritim te Pushtetit Lokal
ne Sadeqiyevge i Administratije
Government Administration

03.03.2025

KLASA 70

Njehsa Organizative	Mbi Emrija	Vlera
-61-	820-125	

- Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit
 - Drejtorisë Përkatesë;
 - Zyrës së Kuvendit;
 - Arkivit

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Gjithashtu, sipas nenit 15 është paraparë zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së.

Meqenëse Drini Halilaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e asamblistit, i cili ka qenë edhe kryesues i komitetit për komunitete, anëtar i KKSB-së, pas mbledhjes së këtij komiteti me datë 05.2.2025 kryesuese është zgjedhur Marigona Bazaj. Gjithashtu, pas dorëheqjes së Donika Zogut nga pozita e udhëheqëses së KVRL-së, Anita Curri e zëvendëson dhe ushtron këtë pozitë. Duke u bazuar në këto arsyeje, kërkohet zëvendësim, përkatësisht ndryshim-plotësimi i KKSB-së me dy anëtarët e rinj.

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-030/01- 6587 dt. 13/02/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3,4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi:

PROPOZIM VENDIM

Për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

Z. Drin Halilaj, zëvendësohet me znj.Marigona Bazaj, Kryesuese e Komitetit për Komunitete

Znj.Donika Zogu, zëvendësohet me znj.Anita Curri, Këshilli i Veprimt Rinor Lokal

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKS-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të zëvendësuar është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Ndërsa, zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së është paraparë me nenin 15 të ligjit të njëjtë.

Meqenëse Drini Halilaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e asamblistit, i cili ka qenë edhe kryesues i komitetit për komunitete, anëtar i KKSB-së, pas mbledhjes së këtij komiteti me datë 05.2.2025 kryesuese është zgjedhur Marigona Bazaj. Gjithashtu, pas dorëheqjes së Donika Zogut nga pozita e udhëheqëses së KVRL-së, Anita Curri e zëvendëson dhe ushtron këtë pozitë. Sipas nenit 15 të udhëzimit të njëjtë, propozohet miratimi i plotësim-ndryshimit të vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me numër të protokollit 12-030-65514, dt 23.12.2021.

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.